



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA FIER**

DREJTORIA E PROJEKTEVE TE INFRASTRUKTURES

NDRICIMI

Shkolla 9-vjecare “Pinellopi Piro” e cila ndodhet ne lagjen “Liri” Fier gjate viteve te fundit ka pasur vetem riparime te pjesshme te cilat kane qene zgjidhje momentale te problemeve dhe kerkesave qe ka pasur kjo qender .Gjate viteve ka patur demtime dhe amortizime te pajisjeve elektrike (celesa ,priza ,kablo ndricimi e fuqie)te cilat kane dale nga funksioni pjesisht ose plotesisht Gjithashtu keto instalime elektrike nuk plotesojne kerkesat per standartet bashkekohore (celesat prizat jane te modelit te vjeter ,si dhe seksionet e kabllave te ndricimit dhe fuqise jane te papershtatshem).Per kete arsye do te rikonstruktohet komplet instalimi i ndricimit te katit perdhe dhe katit te pare te godines se shkolles.Projekti i instalimit elektrik (ndricim ,priza ,kablo ndricimi e fuqie) paraqet punimet per instalimin e sistemit te ndricimit dhe prizave te fuqise ne te gjitha ambientet e brendshme te kesaj godine duke u mbeshtetur ne kerkesat dhe nevojat e sotme per instalime elektrike qe i plotesojne ato si nga pikepamja teknike e sigurimit dhe shfrytezimit teknik te tyre ,ashtu edhe nga pikepamja estetike.Pra ky projekt synon te realizoje shfrytezimin ne kushte sa me optimale te impiantit elektrik te instaluar per kete qellim. Do te nderrohen celesat ,prizat,kablli i ndricimit dhe i prizave te fuqise ,kuadri elektrik , kutite shperndarese, etj) per te vendosur te reja dhe me standartet e kohes.I gjithe rrjeti elektrik do te behet i ri sipas projektit te dhene.Do te vendosen limitatore dhe mbrojtje diferenciale ne te gjithe rrjetin e brendshem te te godines se shkolles. Zgjedhja e pajisjeve te behet ne perputhje me standartet e kohes.

Pajisjet elektrike qe do te demontohen dhe qe jane ne gjendje te mire teknike (nese ka te tilla) te magazinohen sipas kushteve teknike dhe te perdoren per qellime mirembajtje nga drejtoria e sherbimeve komunale.

Sistemi Elektrik

1.Hyrje

Projektet elektrike duhet te respektojne te gjitha konditat projektuese dhe standartet qe jane sot ne fuqi ne Shqiperi (KTP – STASH) dhe per elemente speciale qe nuk parashikohen ne keto standarte duhet ti referohemi Euro norms (EN), dhe Eurostandarteve (EN, ED) dhe rekomandimeve te CEI, CENELC, DIN, VDI/VDE.

2. Shenime teknike mbi materialet e perdorura.

Ne keto projekte jane parashikuar materiale dhe pajisje te prodhuara ne vendet e BE mbas vitit 2005 dhe me minimumi 3 vjet garanci .

Ketu jane dhene kerkesat e pergjithshme si dhe kondita teknike te instalimit te nevojshme per te gjithë aksesoret dhe instalimet elektrike ne pergjithesi. Keto kerkesa te pergjithshme do te plotesohen sikurse jane treguar ne skicat dhe projektet si dhe pershkrimeve apo instruksioneve te projektit.

3. Objekti i punimeve

Punimet qe permbahen ne projekt i perkasin furnizimit dhe venies ne pune te impiantit elektrik te nevojshem. Objekti i ketij relacioni teknik jane edhe normat dhe pershkrimet qe lidhen me furnizimin dhe venien ne pune te pjeseve kryesore dhe aksesoreve te nevojshem per realizimin e ketyre impianteve te ndara si me poshte:

- Impianti i furnizimit me energji elektrike te godines dhe nevojave te tjera.
- Paneli kryesor dhe panelet e tjera
- Impianti i furnizimit te paneleve
- Impianti i shperndarjes te rrjetit elektrik te godines, ndricim, priza fuqie.

Impianti i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike

- Impianti i tokezimit
- Impianti i sinjalizimit kundra zjarrit etj.

4. Konfigurimi i impianteve

Konfigurimi i impianteve eshte ofruar nepermjet:

- Vizatimeve te projektit dhe planimetrive te plota ne seksione dhe ne shkalle
- Skemat elektrike te plota te impianteve te kontrolluara sipas normave

Panelet e komandimit

Relacioni teknik

Eshte e rendesishme te theksohet qe parashikimi i zgjedhjes dhe llogaritjes se pajisjeve te perdorura ne kete projekt eshte bere duke u mbeshtetur ne normat CE.

5. Cilesia e materialit dhe vendi i insatimit

Te gjithë materialet dhe aparatet qe do te perdoren ne impiantet elektrike duhet te pershtaten me ambientin ku jane instaluar dhe duhet te kene karakteristika te tilla qe tu rezistojne veprimeve mekanike, gerryese, termike ose lageshtise dhe agjenteve te tjere ndaj te cileve mund te ekspozohen gjate punes. Te gjithë materialet dhe aparaturat duhet tu pergjigjen Normave CE. Rekomandohet ne zgjedhjen e materialeve, preferenca e prodhimeve europiane. Te gjitha materialet duhet te kene te dhenat targon dhe instruksionet e mundeshme te perdorimit qe perdorin simbolet e CE.

Ing elektrik .Raimonda Xhafa

